

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dalin pamjet: "Goditja e dyfishtë" izraelite vrau fëmijën që ndihmonte mjekun e plagosur në Gaza
ADRESA	https://www.koha.net/bote/dalin-pamjet-goditja-e-dyfishte-izraelite-vrau-femijen-qe-ndihmonte-mjekun-e-plagosur-ne-gaza
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 01:17:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 16:44:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0815ca78456dd03c57fafcbcbdbe5d1c6d5757a64e28261db49fa5843ecda810
TEKSTI	98a92a313916f9f3400c058842c0104d0d4b324ab7da8991797ba0d378b27b38
PAMJA	4bb26faf0b3260f0cdf594d713c7171a87578dfc7380a2e4b1d49f6b20ed49cb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0b9e945b171e895ccf3deaeab6f17cc666a43b660117f6e8aa0b66a581b16ad9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9820c0ddeb45471f928207a963ca36ba3aaf52dec6ebcd920f8d826671ee6c4b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0b9e945b171e895ccf3deaeab6f17cc666a43b660117f6e8aa0b66a581b16ad9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

BOTË

Dalin pamjet: “Goditja e dyfishtë” izraelite vrau fëmijën që ndihmonte mjekun e plagosur në Gaza



18 shtator 2026 18:44

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Mohammad Abdul Zinati po kthehej në shtëpi nga shkolla mes rënjoave në rrugën “Salah Khalaf” të qytetit të Gazës kur u ndal në një market ku një grup i shokëve të tij mblidhej gjithmonë.

Pak para orës 15 e 30, një shpërthim u dëgjua. Mes shumë njerëzve, edhe Mohammadi doli në rrugë për të parë se çka ka ndodhur.

Kur tymi dhe pluhuri u larguan, aty u pa një burrë i gjakosur. Ishte i plagosur rëndë, por ende gjallë. Ai po kërkonte ndihmë dhe Mohammadai vrapoi në drejtim të tij.

15-vjeçari nuk kishte dëgjuar asnjë kushëri të tij që e kishin vënë re afrimin e një droni izraelit. Brenda pak sekondash, droni lëshoi një bombë me aftësi rrëshqitëse, të projektuar për t'ua mundësuar operatorëve identifikimin dhe goditjen e objektivave me shkallë të lartë saktësie.

Municioni u hodh në tokë dhe shpërtheu pak metra para adoleshentit. Mohammadi s'kishte kohë për të reaguar para se shpërthimi i dytë ta vriste.

Edhe



Botë • 1 pri 2026

Irani sulmon Izraelin dhe vendet e Gjirit, një i vdekur e dhjetëra të lënduar

Dëshmitarët dhe ekspertët e armëve kanë folur për “The Guardian” për të hedhur dritë në rastin e vrasjes së këtij fëmije në Gaza.

“Dëgjua shpërthim të madh dhe u përpoqëm të shkonim në vendin e ngjarjes për të parë se çka ndodhi”, ka thënë Tamer Lubbad, dëshmitar që incizoi sulmin. “E gjetëm burrin e shtrirë në tokë. Ishte gjallë dhe po kërkonte ndihmë”.

Më vonë, i plagosuri në sulmin e parë, u identifikua si mjeku Sharif Shadi Labad. Ushtria e Izraelit ka thënë se Labadi ishte cak sepse ishte militant i Hamasit.

Kulturë.

“A Chip Odyssey” dekodon frymën e zhvillimit të Tajvanit

Arbëri.

Jashari: Kosova duhet të sillet si e rritur karshi Evropës dhe Amerikës

Arbëri.

Jashari: PDK-ja duhet ta ketë Ministrinë e Drejtësisë

Futboll.

Brentfordi turpëron Chelsea

LAJMET E MBRËMJES.

Bashkëpunëtorë dhe bashkëveprimtarë e kujtojnë kontributin e Flora Brovinës

Futboll.

Bayerni me fitore 7:0, Kane vendos rekord

Mes njerëzve që iu afruan Labadit ishte edhe kushëriri i Mohamad Zinatit, Rajeh Zinati, 26-vjeçar.

“Dola nga shtëpia për të parë se çka ndodhi. Gjatë rrugës pash kushërin tek dilte nga marketi. Po vraponte drejt vendit të ngjarjes. Bërtita “Mohammed ndal”, por nuk më dëgjoi dhe ecte. Më pas e pash dronin në qiell. Nisa sërish t’i bërtitja “Ik, largohu”. Në atë moment, Mohammadi i ri veçse kishte mbërritur tek i lënduari. Sapo u afrua krejt, droni e goditi edhe atë. Mohammedi u godit në gjoks dhe abdomen dhe vdiq. Nuk mund të bëja asgjë për ta shpëtuar”, ka rrëfyer Zinati.

Izraeli në vazhdimësi ka mohuar pretendimet se ka në cak civilë, duke deklaruar se vlerëson dhe i merr parasysh rreziqet e dëmtimit të civilëve gjatë kryerjes së sulmeve.

Gjithsesi ekspertët e armëve që kanë parë videon kanë thënë se vrasja e fëmijës mund të shmangej.

“Bomba që shihet para shpërthimit është ‘Mikholit’, që lëshohet nga automjetet ajrore pa pilot ose dronët izraelitë”, ka thënë Trevor Ball, studiues luftërash dhe ekspert i dronëve. “Këta dronë janë të pajisur me kamera të cilësisë së lartë, që do të kishin mundësi ta shihnin adoleshentin. Të paktën disa variante të ‘Mikholitit’ kanë kapacitet për t’u ridrejtuar drejt një objekti apo pike tjetër gjatë fluturimit”.

Edhe



Botë • 25 jan 2026

Izraeli vret dy persona në Gazë teksa SHBA-ja kërkon përparim në marrëveshjen e paqes

Sulmi që vrau fëmijën dhe mjekun ngjan në atë që po konsiderohet “sulm i dyfishtë”, kur një shpërthim përcillet nga një i dytë në të njëjtën lokacion, pasi ekipet e shpëtimit apo të tjerë mbërrijnë për të ndihmuar të plagosurit.

Në një deklaratë për “The Guardian”, ushtria e Izraelit ka thënë se Labadi ishte terrorist. Ushtria nuk ka komentuar pse ka ndodhur shpërthimi i dytë, por ka thënë se është dijeni të raportimeve të tilla dhe se i vjen keq për çfarëdo dëmi që u shkaktohet individëve të papërfshirë në luftime.

#DRON

#IZRAELI

#GAZA

Artikuj të ngjashëm



Botë • 18 o. më parë

Palestinezët në Bregun Perëndimor me frikë për jetën e fëmijëve të tyre edhe në shkollë



Botë • 19 gus 2026

Ushtria izraelite e pranon se kishte sulmuar veturën me 5-vjeçaren Hind Rajab në Gazë, nis hetimet



Botë • 28 kor 2026

“Nuk mund të fshihesh nga një sulm me dronë”: Terrori nga qielli në Sudan

Imazhimi dhe kopjimi i KOHA-s me pa lejen e KOHA-s mund të detyrohet nëse autori mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësite që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzim për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.